



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/62

Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 58 dhe 59 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/62

Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Kërkesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës/Komisionit për Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25,000.00 (njëzetepesë mijë) eurove.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/62

Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A" ("PTK"), vendos që Ministri i Financave ("Ministri"), të autorizohet dhe urdhërohet të veproj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimit në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjrisht:
  - 1.1. Të kërkojë nga PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve që të deklarojnë dhe të paguaj një dividendë ("Dividenda") për aksionarin në shumën prej tridhjetepesë milion (35,000,000.00) euro;
2. Obligohet Ministri i Financave që në bashkëpunim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe me Bordin e Drejtorëve të PTK, Sh.A të caktojë dinamikën e ekzekutimit të obligimit në pajtim me pikën 1.1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/62


Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi, për interes publik, të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në zonat kadastrale të komunave Obiliq, Vushtri, Prishtinë dhe të cilat preken nga ndërtimi i Fabrikës së Ujit në fshatin Shkabaj dhe shpronësimin me vënien e të drejtës të servitutit në dobi të KUR "Prishtina" Sh. A. me kompensimin e dëmeve të pronarëve për ngastrat kadastrale të cilat preken nga ndërtimi i trasesë për vendosjen e gypit kryesor të ujësjellësit, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave, KUR Prishtina dhe Kuvendet Komunale të Prishtinës, Obiliqit dhe Vushtrisë në territorin e të cilave gjenden ngastrat kadastrale.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që në bashkëpunim me Kuvendet Komunale të Prishtinës, Obiliqit dhe Vushtrisë, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

5. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/62


Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi, për interes publik, të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në zonat kadastrale të komunave Lipjan dhe Graçanicë, të cilat preken nga ndërtimi Linjës L 112,110kV, ndërtimi i shtyllave dhe vendosja e stabilimenteve për zgjerim të rrjetit energjetik dhe shpronësimin me vënien e të drejtës të servitutit në dobi të KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.) me kompensimin e dëmeve të pronarëve për ngastrat kadastrale, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave, Kompania Publike „Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut“ Sh.A. (KOSTT) dhe Kuvendet Komunale të Lipjanit dhe Graçanicës në territorin e të cilave gjenden ngastrat kadastrale.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që në bashkëpunim me Kuvendet Komunale të Lipjanit dhe Graçanicës, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.

4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
  
5. Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/62

Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të ligjit nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-106, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë".
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për Shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/62

Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 50 të Ligjit nr. 03 /L-163 për Minierat dhe Minerale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Lista për Rentat Minerare që bartësit e licencave duhet t'i paguajnë për ushtrimin e aktiviteteve të licencuara për shfrytëzimin e Resurseve Minerale në Kosovë.
2. Lista për Renta Minerare është pjesë e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me listën e propozuar në paragrafin 2. të këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/62


Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Qeveritar, për Manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila do të organizohet nën patronazhin e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi më 5, 6 dhe 7 mars në këtë përbërje:
  - 1.1. Agim Çeku, Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
  - 1.2. Bajram Rexhepi, Ministër i Punëve të Brendshme, anëtar;
  - 1.3. Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, anëtar;
  - 1.4. Gani Koci, Zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
  - 1.5. Një këshilltar i Kryeministrit, anëtar;
  - 1.6. Një përfaqësues i Komunës së Skenderajt, anëtar;
  - 1.7. Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, anëtar.
2. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e pikës 2. dhe 3. e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/62


Datë: 22.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Ndërministror për udhëheqjen e projektit për zhvillimin e Brezovicës dhe për zbatimin e procedurave me qëllim të zhvillimit të projektit duke u bazuar në investimet private, në këtë përbërje:
  - 1.1. Mimoza Kusari-Lila, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, Kryesuese;
  - 1.2. Sllobodan Petrovic, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
  - 1.3. Bedri Hamza, Ministër i Financave, anëtar;
  - 1.4. Vlora Çitaku, Ministre e Integrimit Evropian, anëtare;
  - 1.5. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
  - 1.6. Blerand Stavileci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
  - 1.7. Bratislav Nikolic, Kryetar i Komunës së Shtërpcës, anëtar.
2. Në përputhje me procedurat e Partneritetit Publiko-Privat, Komisioni merr vendime lidhur me aprovimin e projektit të Brezovicës dhe çdo vendim tjetër me shumicë votash, duke përfshirë votën afirmative të Ministrit të Financave dhe Kryetarit të Komunës së Shtërpcës.
3. Projekti për zhvillimin e Malit Sharr-Brezovicës shpallet projekt me interes të përgjithshëm publik.

4. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të rishikojë legjislacionin ekzistues sekondar në lidhje me transferimin ose dhënien me qira të pyjeve dhe tokave pyjore publike me qëllim që të sigurohet që rregullat dhe procedurat përkatëse të jenë të përshtatshme për projektet e mëdha infrastrukturore që janë me interes të përgjithshëm publik.
5. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/41 i datës 10 tetor 2011.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë